



Bundesamt
für Migration
und Flüchtlinge



Kartela elektronike e lejes së qëndrimit

ALBANISCH



Migration



Përmbajtja

4 Së pari më e rëndësishmja

6 Kartela e juaj elektronike e lejes së qëndrimit

7 Funkzioni i identifikimit tuaj në internet
Për identifikimin online ju nevojiten këto
Indentifikimi në internet është fare i thjeshtë
Mbrojtje efektive për të dhënat tuaja
Këtu mund të përdorni funksionin e identifikimit online
E drejta e juaj – vetvendosje për paraqitjen e të dhënave
Leximi në vend

14 Funksione të mëtejshme

15 Letra e PIN-it tuaj

16 Udhëzimet e sigurisë

17 Bllokimi hotline

18 Në internet

19 Dëftues botimi

Së pari më e rëndësishmja

Ju keni marr nga Zyra e migrimit një leje elektronike të qëndrimit. Kjo mund të jetë një leje e qëndrimit, kartela BE blu, ICT-kartelë, ICT kartelë mobile, leje të qëndrimit të përhershme ose leje për qëndrim të përhershëm në BE.

Zakonisht, për shembull, mund të përdorni lejen e qëndrimit së bashku me pasaportën tuaj në jetën e përditshme / të identifikoheni në zyrat civile, në bankë apo institucionet.

Në internet është ndryshe: Po që se vizitoni një ueb faqe, ofruesi nuk qëndron personalisht para jush. Megjithatë do të mund të identifikoheni, përdorisa funksioni për identifikimin në internet e lejes së qëndrimit tuaj është aktivizuar përmes Zyrës së migrimit.

Identifikimin elektronik ua mundëson mediumi për incizim (çip), që gjindet në kartelë. Në të janë të regjistruar të dhënat tuaja personale (emri, datëlindja, shtetësia, adresa e vendbanimit), veçoritë biometrike (fotografia dhe shenjat e gishtave) si dhe specifikime të veçanta (kushtet e veçanta). Përmes kësaj ju do të mund të kryeni shpejt dhe efikas shërbimet, që ofrohen nga ana e institucioneve në internet si dhe shërbimeve komerciale në internet.

Të dhënat tuaja janë gjithmonë të mbrojtur nga vjedhja apo keqpërdorimi. Kjo është e rëndësishme, sepse në internet shpesh çon në vjedhjen e identitetit: Dikush i merr të dhënat e tuaja të identifikimit, pra për shembull emrin përdorues dhe fjalëkalimin tuaj, merr identitetin tuaj dhe vepron në emrin tuaj. Nga kjo ju mbron funksioni online i identifikimit të kartelës elektronike të lejes së qëndrimit. Përdorimi i funksionit të identifikimit në internet është vullnetar.

Në këtë broshurë do të njohoheni, se për çfarë mund të përdoret kartela elektronike e lejes së qëndrimit në jetën e përditshme në Gjermani, se si ta përdorni në botën digjitale dhe me cilat mekanizma të sigurisë mbrohen të dhënat tuaja personale.

Veç kësaj, lexoni se si përdoren të dhënat biometrike në kartelën e lejes së qëndrimit tuaj, se sa e rëndësishme është letra e PIN-it tuaj, të cilën e keni marrë, pasi është prodhuar kartela juaj elektronike e lejes së qëndrimit dhe se cilat udhëzime të sigurisë duhet t'i keni parasysh.





Kartela e juaj elektronike e lejes së qëndrimit

Vështrim



- 1 Fotografia
- 2 Simboli i mediumit për ruajtjen elektronike (çip)
- 3 Mbiemri, Emri
- 4 Numri serik
- 5 Shtetësia
- 6 Dita lindjes
- 7 Dita e fundit e afatit të vlefshmërisë
- 8 Numri i qasjes (CAN)

Në faqen e përparme të titullit elektronik të qëndrimit janë të regjistruar mbiemri dhe emri juaj (emrat tuaj) si dhe të dhënat për gjininë tuaj, shtetësinë tuaj dhe datëlindja tuaj.

Në faqen e përparme janë shënuar edhe lloji i titullit të qëndrimit, afati i vlefshmërisë së kartelës me datë dhe eventualisht shënime për kushte anësore. Afati i vlefshmërisë së kartelës varet nga vlefshmëria e titullit tuaj të kufizuar të qëndrimit. Nëse posedoni një titull qëndrimi të pakufizuar, atëherë kartela merr një vlefshmëri maksimale prej 10 vjetësh dhe pastaj duhet të lëshohet sërish. Ndërkohë, titulli elektronik i qëndrimit në çdo rast e ka afatin e skadimit vetëm deri në skadimin e pasaportës ose zëvendës-pasaportës, që lidhet me të dhe që është gjithashtu e regjistruar në faqen e përparme të kartelës. Prandaj ju lutemi të keni kujdes, që të aplikoni me kohë për një pasaportë ose zëvendës-pasaportë të re, para se të kalojë afati i vlefshmërisë.

Sipër në anën e djathtë të faqes së përparme të kartelës ndodhet numri serik i titullit elektronik të qëndrimit, i cili përsëritet në anën e majtë sipër me shkronja më të vogla. Poshtë tij ndodhet fotografia. Në mes të pjesës së poshtme jepet nënshkrimi juaj dhe në anën e djathtë poshtë është numri i qasjes (Card Access Number/CAN).



- 1 Vendi i lindjes
- 2 Adresa
- 3 Zyra që ka lëshuar dokumentin
- 4 Logoja: Funkioni i identifikimit në internet
- 5 Zona e makinave lexuese (nuk përmban të dhëna shtesë për personin)

Në faqen e pasme të titullit elektronik të qëndrimit mund të ketë një udhëzim për shënime në një fletë shtesë. Janë shënuar të dhënat tuaja personale për vendin e lindjes, ngjyrën e syve, gjatësinë dhe adresën tuaj të banimit. Në fund është shënuar data e lëshimit të kartelës dhe Autoriteti për të huajt, që e lëshoi. Pjesa e poshtme e faqes së pasme të kartelës përmban zonën për lexim makine, ku nuk ka të dhëna të tjera për personin tuaj.

Në titullin elektronik të qëndrimit ka një mjet elektronik regjistrimi (çip). Me ndihmën e një aparati për leximin e kartelave ose me anë të një smartfoni ose tableti të përshtatshëm dhe të aftë për NFC (NCF Near Field Communication) mund ta shfrytëzoni funksionin e identifikimit online për kryerjen e bizneseve dhe aktiviteteve në internet dhe nëpër automate.

Logoja në anën e djathtë sipër i shënon të gjitha aplikacionet e internetit, automatet dhe aparatet për leximin e kartelave, tek të cilat mund të shfrytëzoni funksionin online.



Funksioni i identifikimit tuaj në internet

Kartela juaj e lejes së qëndrimit për botën digjitale

Me kartelën tuaj elektronike të lejes së qëndrimit mund të përdorni funksionin e identifikimit online dhe të identifikoheni në internet apo automate. Ju thjesht vizitoni autoritetin për procedurat tuaja administrative apo çështjet e biznesit në mënyrë elektronike. Kjo ju kursen rrugën, kohën dhe kostot.

Të dhënat tuaja në botën digjitale janë të mbrojtura kështu:

- Para përcjelljes së të dhënave tuaja personale mund të shihni, kush i pranon ato dhe nëse është i autorizuar që të përdorë funksionin e identifikimit online.
- Që të mund të transmetohen të dhënat tuaja në mënyrë elektronike, do të duhet që të jepni numrin tuaj sekret personal identifikues (PIN-in).
- Të dhënat e tuaja personale do të transmetohen gjithmonë të koduar dhe nuk mund të interceptohen apo të shikohen.

Pra me funksionin e identifikimit online ju caktoni vetë, nëse dhe kujt doni t'i transmetoni të dhënat tuaja personale në formë të koduar.

Asnjë funksion për identifikimin online

Nëse kartela elektronike e lejes së qëndrimit përmban udhëzime, nëse të dhënat personale bazohen në informacionin e siguruar nga pronari apo pronarja, përjashtohet përdorimi i funksionit të identifikimit online.

Funksioni i identifikimit online mund të përdoret kryesisht prej moshës 16 vjeç.

Për identifikimin online ju nevojiten këto


Për të përdorur funksionin e identifikimit tuaj online, ju nevojiten:



Identifikimi në internet është fare i thjeshtë



Kudo që e shihni logon e identifikimit, aty do të mundeni të identifikoheni në mënyrë digjitale.



Mbrojtje efektive për të dhënat tuaja

Katër mekanizma të sigurisë i mbrojnë me besueshmëri të dhënat tuaja personale.

1

Kombinimi i posedimit dhe i njohurive

Funksionin e identifikimit në internet mund ta përdorë vetëm ai, që posedon kartelë elektronike e lejes së qëndrimit, dhe me numrin e tij sekret identifikues (PIN-in).

I ashtuquajtur *verifikim me dy faktorë* është më i sigurt se verifikimi i zakonshëm me një faktor me emrat e përdoruesve dhe fjalëkalimet.

2

Identifikimi i dyanshëm

Gjatë identifikimit në internet gjithmonë dëshmohen të dyja palët. Andaj ju mund të shikoni saktësisht, se kujt do t'ia transferoni të dhënat tuaja. **Personi përballë jush në rrjet duhet të posedojë një certifikatë të vlefshme shtetërore për pyetjen mbi të dhënat personale.** Kjo certifikatë duhet të shfaqet. Nëse jeni dakord, ju pranoni transmetimin duke e shtypur PIN-in tuaj.

Dëshmia e identifikimit të ndërsjelltë e rrit sigurinë tuaj në botën digjitale.

3

Parakushtet për transmetim e të dhënave

Transferimi i të dhënave tuaja do të pasojë vetëm atëherë, kur do ta lidhni kartelën tuaj elektronike të lejes së qëndrimit me aparatën lexues për kartela apo me një smartfonë të përshatshëm me NFC gjegjësisht tabletin dhe pasi ta keni dhënë PIN-in.

Në këtë mënyrë të dhënat nuk mund të lexohen pa dijeninë tuaj. Gjithashtu ato janë të mbrojtura nga humbja apo vjedhja e kartelës elektronike e lejes së qëndrimit.

4

Kodimi nga fillimi deri në fund

Të dhënat do të transferohen ekskluzivisht të koduar.

Përmes kodimit nga fillimi deri në fund mbrohen të dhënat tuaja nga vjedhja dhe keqpërdorimi.

Këtu mund

të përdorni funksionin e identifikimit online

Ju mund të përdorni funksionin e identifikimit online për marrjen e më shumë shërbimeve pranë institucioneve qeveritare, si për shembull:

- **Regjistrimi online**
Gjatë regjistrimit të parë në internet shpesh do të jeni i pyetur për të dhënat e ndryshme. Kjo mund të jetë emri, në disa raste edhe komplet adresa. Me ndihmën e kartelës elektronike të lejes së qëndrimit, këto të dhëna do të mund të barten shpejt dhe pa gabime.
- **Verifikimi i moshës ose vendbanimit**
Disa shërbime mund të përdoren vetëm nga persona, të cilët kanë arritur një moshë të caktuar apo edhe të jenë të lajmëruar në një vendbanim të caktuar. Pa dhënë të dhëna të tjera, kartela elektronike e lejes së qëndrimit mund ta konfirmojë moshën dhe vendbanimin. Ato zakonisht do të transferohen vetëm me një përgjigje “Po” ose “Jo”.
- **Plotësimi automatik i formularëve**
Plotësimi i formularëve në internet shpesh është i lodhshëm. Shpejt ndodhin gabime shtypi, kur shkruani emrin apo adresën. Funksioni i identifikimit online mundëson që t'i që të merren këto të dhëna nga kartela elektronike e lejes së qëndrimit.
- **Identifikimi pranë automateve**
Po ashtu edhe tek automate për shitje dhe informacion në të ardhmen gjithmonë e më shumë po ofrohen shërbime të personalizuar. Këtu gjithashtu do të mund të identifikoheni shpejt dhe thjesht përmes kartelës suaj elektronike të lejes së qëndrimit.
- **Hyrja me pseudonim**
Pseudonimi është një identifikues, që rrjedh nga çipi, që gjendet në kartelën elektronike të lejes së qëndrimit – në varësi të ofruesit përkatës të shërbimit. Për shembull përmes kësaj do të mund të identifikoheni në rrjetet sociale, duke mos i transferuar të dhënat tuaja. Pas regjistrimit të parë, shërbimet do të ju identifikojnë çdo herë që vizitoni përsëri, pa transferuar të dhënat tuaja.
- **Formularët tek administrata publike**
Shumë institucione gjithnjë e më shumë do të ofrojnë shërbimet e tyre gjithashtu edhe në internet (p.sh. për pyetjen e gjendjes tek Shoqata Federale e automjeteve motorike (Kraftfahrtbundesamt)). Funksioni i identifikimit online jep dëshmi të sigurt të identitetit lidhur me këtë ofertë.

Informacione të mëtejshme

Informacione të mëtejshme mund t'i gjeni në portalin e kartës së identitetit
www.personalausweisportal.de



E drejta juaj – vetëvendosje për paraqitjen e të dhënave

Së fundit ju vendosni vetë, se cilat të dhëna do të duhen të transferohen.

Parakushti është, që kartela e juaj elektronike e lejes së qëndrimit të jetë e vlefshme.

Gjatë çdo transferimi, të dhënat tuaja do të jenë të koduar. Të gjitha informacionet dhe transferimet do të mbrohen me procedurën e vendosur dhe e njohur ndërkombëtarisht për kodim.

Funksioni i identifikimit online kontrollon, nëse ofruesi online është në të vërtetë ai, për të cilën pretendon të jetë.

Çdo ofrues online, i cili për shërbimet e veta dëshiron të përdorë kartelën elektronike të lejes së qëndrimit, do të duhej që të aplikojë për marrjen e certifikatës shtetërore të autorizimit përkatës pranë Autoritetit për dhënien e Certifikatave të Autorizimit (VfB). Autoriteti kontraktues kontrollon sipas specifikimeve të rrepta, se cilat të dhënat janë të domosdoshme për të ofruar shërbimin dhe jep leje vetëm për këto të dhëna.

Përmes dhënies së PIN-it mund të transmetohen këto të dhëna siç vijojnë:



Leximi në vend

Gjithkund aty, ku të dhënat personale siç janë emri dhe adresa duhet të përfshihen në një formular, ju ofrohet leximi në vend. Kartelën tuaj elektronike të lejes së qëndrimit e vendosni mbi aparatën adekuat për lexim dhe të dhënat do të lexohen dhe do të merren për transferim. Kjo bëhet shpejt dhe parandalon gabime shtypi.

Institucionet dhe ndërmarrje, t që ofrojnë këtë funksion, duhet të posedojnë leje shtetërore për leximin në vend si dhe një aparat të përshtatshëm për lexim.

Leximi në vend bëhet kështu:

- 1 → Te sporteli pranë institucionit ua tregoni kartelën tuaj elektronike të lejes së qëndrimit dhe pasaportën tuaj të vlefshme dhe me këtë dëshmohet identiteti i juaj ndaj institucioneve dhe ndërmarrjeve.
- 2 → Ju e vendosni kartelën tuaj elektronike të lejes së qëndrimit mbi aparatën për lexim.
- 3 → Përmes çipit do të kontrollohet, nëse ofruesi është i autorizuar, që të pyesë në vend për të dhënat tuaja personale.
- 4 → Të jepet numri i qasjes (CAN). Atë e gjeni djathtas në faqen e përparme të kartelës elektronike të lejes së qëndrimit pranë datës së vlefshmërisë.
- 5 → Të dhënat tuaja do të transferohen në formular të sigurt me kodimin fundi nga fillimi deri në fund dhe pa gabime.


Për mbrojtjen e të dhënave tuaja

Nuk është e mundur që të lexohen fshehurazi të dhënat tuaja nga çipi pa dijeninë tuaj. Çipi i transferon të dhënat, kur e merr të transmetuar numrin sekret identifikues (PIN-in) apo numrin e qasjes (CAN), që është i shtypur mbi kartelën e lejes së qëndrimit.

Vetëm institucionet, të cilat janë ligjërisht të autorizuar për konstatimin e identitetit, ato mundën t'i lexojnë të dhënat biometrike që gjenden në çipin e kartelës suaj elektronike të lejes së qëndrimit. Fotografia dhe shenjat e gishtave nuk mund të përcillen as gjatë identifikimit online por as gjatë leximit në vend.

Funksione të mëtejshme

Leximi përmes institucioneve të sigurisë



Në çipin e kartelës suaj elektronike të lejes së qëndrimit janë të incizuara të dhënat tuaja personale dhe biometrike. Këto mund të lexohen vetëm për qëllime zyrtare nga ana e policisë, të zyrës për migrim, të autoriteteve kufitare dhe doganore, kur kartela elektronike e lejes së qëndrimit është në dispozicion. Me këtë bëhet krahasimi i fotografisë ndoshta edhe shenjave të gishtërinjve, që janë të incizuar në çip me personin, i cili legjitimohet me kartelën elektronike të lejes së qëndrimit së bashku me dokumentin shoqërues të udhëtimit. Tentimet për mashtrim me kartelën e vjedhur të lejes së qëndrimit vërehen menjëherë. Nuk është i mundshëm leximi i informacioneve biometrike përmes internetit.

▪ Fotografia biometrike

Në fotografinë biometrike fytyra duhet të jetë në qendër dhe të jetë e dukshme nga përpara. Mbulesa e kokës nuk guxon ta mbulojë fytyrën, sytë duhet të jenë të hapur dhe të dukshëm. Përrjashtime tolerohen për shembull për shkaqe mjekësore. Fotografia është e printuar mbi kartelë dhe është e incizuar në mënyrë elektronike në çip.

▪ Shenjat e gishtit

Kur paraqitni kërkesën pranë Zyrës së migrimit për kartelë elektronike të lejes së qëndrimit, nga ju do të merren shenjat e gishtit të të dy gishtërinjve tregues. Këto do të incizohen në çipin e kartelës. Shenjat e gishtit do të incizohen përkohësisht nga Zyra e migrimit dhe Shtypshkronja Federale (Bundesdruckerei GmbH) dhe pas krijimit të kartelës elektronike të lejes së qëndrimit do të shlyhen sërish ato. Tek fëmijët, që janë të moshës nën gjashtë vjeç, nuk do të merren shenjat e gishtave.

▪ Specifikime të veçanta

Specifikimet e veçanta dhe kushtet e tjera gjithashtu do të incizohen në çipin e kartelës elektronike të lejes së qëndrimit dhe do të shtypen në një letër shtesë. Letra shtesë do të bashkëngjitet së bashku me kartelën elektronike të lejes së qëndrimit. Në rastet e veçanta, specifikat e veçanta do të ngjiten përmes një etikete në pasaportën tuaj.




Letra e PIN-it tuaj

Informacione të rëndësishme për ju

Pas prodhimit të kartelës suaj elektronike të lejes së qëndrimit do të merrni një letër me PIN me informacione lidhur me kartelën tuaj elektronike të lejes së qëndrimit si dhe funksionin e identifikimit online.

Letra me PIN përmban informacione të rëndësishme për ju:



Andaj ju lutemi, që letrën e PIN-it ta ruani në një vend të sigurt. Këto informacione duhet të jenë të njohur vetëm për ju.

Letrën e PIN-it do ta merrni, kur në momentin e aplikimit i keni mbushur të paktën 16 vjet. Nëse jeni më i ri, nuk do të mund ta përdorni funksionin e identifikimit online, andaj dhe nuk do të merrni letër me PIN. Pas mbarimit të moshës 16 është e mundur që pranë Zyrës së migrimit, ku ju banoni, që të aktivizoni falas funksionin për identifikimin online. Pastaj ju do të mund të përdorni PIN-in tuaj personal gjashtëshifror dhe fjalëkalimin për bllokim pasi t'ua dërgojnë këto.

▪ PIN-i i juaj gjashtëshifror

(Personal Identification Number)

Në çdo kohë mund të vendosni vetë, se kur dhe nëse dëshironi ta përdorni PIN-in tuaj personal gjashtëshifror. Pas marrjes së kartelës elektronike të lejes së qëndrimit, mundeni të zëvendësoni PIN-in pesëshifror të aktivizimit (gjithashtu quhet edhe transport - PIN), të marrë nga letra e PIN-it, me atë të PIN-it personal gjashtëshifror. Këtë mund ta bëni në shtëpi pranë PC me ndihmën e aparatit lexues për kartela ose një smartfonë të përshtatshëm që ka aftësinë për NFC gjegjësisht në tablet apo edhe në vend pranë Zyrës së migrimit në vendin ku ju banoni. Funksioni për identifikimin online do të jetë në dispozicion për përdorim pasi të keni përfunduar këtë proces. Sakaqherë që dëshironi të përdorni funksionin e identifikimit online do të ju nevojitet PIN-i i juaj personal gjashtëshifror.

▪ Numri i qasjes (Card Acces Number/CAN)

Po që se e keni dhënë dy herë gabimisht PIN-in tuaj personal gjashtëshifror, atëherë do të duhej që përpos PIN-it tuaj gjashtëshifror të jepni gjithashtu edhe numrin e qasjes (CAN). Ai ndodhet në faqen e përparme të kartelës suaj elektronike të lejes së qëndrimit në anën e djathtë - poshtë. Numri i qasjes gjithashtu nevojitet edhe për leximin në vend.

▪ PUK (Personal Unblocking Key)

Po që se keni dhënë tre herë gabimisht PIN-in tuaj, do të bllokohet funksioni për identifikimin online. Që të mund ta aktivizoni sërish, duhet të jepni PUK-un. PUK-un mund ta gjeni në letrën e PIN-it tuaj.

▪ Fjalëkalimi për bllokim

Po që se e keni humbur kartelën elektronike të lejes së qëndrimit apo iu është vjedhur, pa hezituat duhet ta njoftoni Zyrën e migrimit apo edhe Hotline për bllokim që ta bëjnë menjëherë bllokimin e saj. Tregoni nëpunëses apo nëpunësit fjalëkalimin për bllokim, e cila gjendet në letrën e PIN-it tuaj.

Udhëzimet e sigurisë

Kontributi juaj për sigurinë



Ju lutemi të keni parasysh këtë udhëzim të sigurisë:

- Ruajeni gjithmonë sigurt kartelën tuaj elektronike të lejes së qëndrimit.
- Numrin tuaj sekret personal i juaj gjashtëshifror (PIN-i) duhet ta dini vetëm ju. Mos përdorni kombinime të lehta numëror për t'ia qëlluar, pra as 123456, apo as ditëlindjen tuaj as numra, të cilat mund të lexohen në kartelën tuaj elektronike e lejes së qëndrimit.
- Mos ia jepni personit të tretë PIN-in tuaj. Mos e ruani PIN-in tuaj së bashku me kartelën tuaj të lejes së qëndrimit dhe aksesit mos e shënoni PIN-in mbi të.
- Ju lutem ruajeni letrën e PIN-it në një vend të sigurt. Kjo letër me PIN përmban informacione të rëndësishme.
- Mënjajeni kartelën e lejes së qëndrimit menjëherë pas leximit e të dhënave nga aparati për leximin e kartelave gjegjësisht mënjajeni kartelën nga smartfoni i juaj i pajisur me aftësinë NFC apo nga tableti.
- Rregullisht rifreskoni sistemin tuaj operativ, programin për mbrojtjen nga viruset si dhe Firewall tuajën.
- Po që se keni humbur kartelën tuaj elektronike të lejes së qëndrimit apo është vjedhur ajo, atëherë pa hezituar njoftoni Zyrën e migrimit dhe bllokoni funksionin e identifikimit online. Bllokimi ju siguron që çdo përpjekje për keqpërdorim të njihet menjëherë.



Bllokimi hotline

Mund të na kontaktoni në çdo kohë



116 116

Udhëzime lidhur me bllokimin hotline

Bllokimi Hotline përmes telefonit është në dispozicion në çdo kohë shtatë ditë në javë nën numrin **116 116**, ku thirrja është falas. Po që se ndodheni jashtë vendit, atëherë paraqituni në numrin telefonik **0049-116 116** ose **0049-3040 50 40 50** (me pagesë).

Ju lutemi që gjatë telefonatës të keni të gatshëm fjalëkalimin tuaj për bllokim e cila ju është njoftuar te letra e PIN-it.

Funksioni i identifikimit online dhe leximi në vend pas bllokimit nuk janë më në funksion.





Mënjanimin e bllokimit mund të kërkonti pranë ndonjë Zyre të migrimit.

Gjithsesi njoftoni pa hezituat Zyrën përkatëse të migrimit lidhur me humbjen e kartelës suaj elektronike të lejes së qëndrimit.



Në internet

Këto janë ueb portale më të rëndësishme për kartelën elektronike të lejes së qëndrimit me funksionin e identifikimit online



www.ausweisapp.bund.de
Shkarkimi falas i
AusweisApp2 dhe Support
përmes telefonit dhe E-mail

www.bsi-fuer-buerger.de
Informacione të dobishme
për sigurinë tuaj në internet

Fjalor

123456



CAN: Card Access Number; Numri i qasjes




eAT: elektronischer Aufenthaltstitel
(Kartela elektronike e lejes së qëndrimit)



BE: Bashkimi Evropian



ICT: Intra Corporate Transfer
(Transferimi brenda korporatës)



NFC: Near Field Communication; Rrjeti standard për transmetimin e të dhënave pa tel (ajror) përmes një distance të shkurtër prej pak centimetrash.



PIN: Personal Identification Number;
Numri personal identifikes



PUK: Personal Unblocking Key;
Numri 8 shifror për ç'bllokim



VfB: Vergabestelle für Berechtigungszertifikat
(Autoriteti për dhënien e Certifikatave të Autorizimit)

Dëftues botimi

Botuesi:

Bundesamt für Migration und Flüchtlinge
90461 Nürnberg

Gjendja:

04/2020; 2. versioni i aktualizuar

Krijimi:

KonzeptQuartier® GmbH, 90762 Fürth
Përditësim: MediaCompany – Agentur für Kommunikation GmbH

Vërtetim fotografish:

iStock/andresr, Giulio Fornasar, Geber86, pixdeluxe, Weekend Images Inc.
Bundesministerium des Innern, für Bau und Heimat

Ikonat:

KonzeptQuartier® GmbH, 90762 Fürth
Fink & Fuchs AG, 65205 Wiesbaden

Internet:

www.bamf.de/eAT

Mundësitë e porositjes:

Ju mund ta shkarkoni këtë publikim edhe si dokument PDF pa pengesa.
www.bamf.de/publikationen

Ky publikim do të botohet nga Enti Federal për Migracion dhe Refugjatë në kuadrin e punës së tij publike. Publikimi jepet falas dhe nuk është përcaktuar për t'u shitur. [Ai nuk lejohet të përdoret as nga partitë, as nga kandidatët e zgjedhjeve ose nga ndihmësit e zgjedhjeve gjatë një fushate zgjedhore me qëllime reklamimesh për zgjedhjet. Kjo vlen për zgjedhjet e federatës, e landit dhe komunale si dhe për zgjedhjet e Parlamentit Evropian.



Na vizitoni ne në

www.facebook.com/bamf.socialmedia

[@BAMF_Dialog](https://twitter.com/BAMF_Dialog)

www.bamf.de

